



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-32252 /2024

Datë: 29.07 /2024

Duke u bazuar ne nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/L-040, publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr.28/2008, nenin 25 paragrafi 6 te Ligjit për Dhënien ne Shfrytëzim dhe Këmbim te Pronës së Paluajtshme te Komunës, nr.06/L-092 publikuar ne Gazetën Zyrtare, nr. 10/2019, nenin 31 paragrafi 2 te Rregullores se QRK-së nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave te Dhënies ne Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme te Komunës, dispozitat e nenit 10 të Statutit te Komunës se Klinës, nr. 01-110-1232/2010 te miratuar me datën 31.03.2010, pas shqyrtimit te propozimit të Kryetarit të Komunës 01-463-29088/24 të datës 28.08.2024 si dhe me rekomandimin e KPF-së, Kuvendi i Komunës se Klinës ne seancën e VIII-të të rregullt të mbajtur më datën 20.09.2024, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e propozimit te kryetarit të komunës për këmbim te pronës se paluajtshme të komunës me prone private

1. Miratohet, Propozimi i kryetarit të Komunës se Klinës, nr. **01-463-29088/24** i datës **28.08.2024** qe ka te bej me këmbimin e pronës se paluajtshme të komunës se Klinës, me pronën e paluajtshme ne pronësi të pronareve privat Bujar dhe Zoje Dakaj bashkëpronar 1/2.
2. Prona e paluajtshme komunale e cila jepet ne emër te këmbimit pronareve privat Bujar dhe Zoje Dakaj është pjesa e parcelës nr.P- 71010027-01949-0 më sipërfaqe **219 m²** (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror) ZK Dresnik vendi i quajtur Preline e regjistruar në emër të **Pronë Shoqërore Rrugët**.
3. Prona private e cila merret ne emër te këmbimit është pjesa e parcelës kadastrale, nr. **P-71010027-02246-0** ZK Dresnik, më sipërfaqe **219 m²** (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror), vendi i quajtur Preline livadhi pa vad, e regjistruar në emër të pronareve privat Bujar dhe Zoje Dakaj bashkëpronar 1/2.
4. Qëllimi i këmbimit te pronës se paluajtshme është realizimi i planit rregullues për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit rregullim i trotuarit dhe shtegut të biçikletave dhe zgjerimi i kryqëzimit të rrugës.
5. Me rastin e hyrjes ne fuqi te këtij vendimi, autorizohet kryetari e komunës të nënshkruaj kontratën e këmbimit duke specifikuar te drejtat dhe obligimet e palëve.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryetari i komunës në bashkëpunim me drejtorin për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi.

7. Ky vendim hyn në fuqi 15 dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së konform nenit 81 të LVL-së, përkatësisht 7 dite pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës e Klinës.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Pronarët;
- Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronësi;
- Zyra për Informim;
- Arkivi;



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**